

LIGJ
Nr. 42/2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 64/2012
“PËR PESHKIMIN”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 30 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Numri maksimal i lejeve të peshkimit tregtar artizanal përcaktohet nga ministri, në zbatim të planit të menaxhimit të peshkimit dhe të planit të zbatimit të peshkimit.”.

2. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Leja e peshkimit tregtar ka një kohëzgjatje 10-vjeçare, e cila tregohet qartë në leje. Me mbarimin e këtij afati, leja rinovohet pas dorëzimit më parë të kërkesës përkatëse nga ana e pronarit të anijes së peshkimit.”.

3. Pas pikës 7 shtohen pikat 8, 9, 10 dhe 11 me këtë përmbajtje:

“8. Leja e peshkimit jepet për anijet e peshkimit të regjistruara në regjistrin e anijeve të peshkimit dhe të pajisura me numrin unik identifikues NFR.

9. Të gjitha anijet e peshkimit të regjistruara në regjistrin e anijeve të peshkimit dhe të pajisura me NFR, por që u ka mbaruar afati i vlefshmërisë së lejes së peshkimit dhe nuk e kanë rinovuar atë, kanë të drejtë të aplikojnë për rinovimin e lejes së peshkimit, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

10. Nuk lëshohen leje të reja peshkimi për anijet e peshkimit që zhvillojnë format e peshkimit me rrjeta tërheqëse (fundore ose pelagjikë, veçmas ose së bashku), me rrethim (koshilok) për peshkimin e pelagjikëve të vegjël dhe të mëdhenj, dragat hidraulike (turbosofiante), linja grepash dhe të gjitha format e peshkimit tregtar profesional. Për anijet e peshkimit që zhvillojnë format e peshkimit me rrjeta tërheqëse, të cilat janë të pajisura me leje peshkimi për të dyja format së bashku, lejohet ndryshimi i lejes duke kaluar vetëm në rrjeta tërheqëse fundore.

11. Leje të reja të peshkimit jepen vetëm për anije peshkimi:

a) me tonazh dhe fuqi motorike më të vogël ose të barabartë me një anije peshkimi me leje të vlefshme peshkimi, si zëvendësim i saj;

b) të mbytura, të cilat ishin të pajisura një leje të vlefshme peshkimi, si zëvendësim i saj. Në këtë rast kërkesën për leje peshkimi e bën pronari i anijes së mbytur ose trashëgimtarët e tij.”.

Neni 2
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratur në datën 23.4.2020